

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“N & A Services Fornitures” SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më date 23.08.2024 ne, te nenshkruarit:

**Armand Zeneli**, lindur ne Durres, i datëlindjes 18.12.1986, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti I61218058E

**Nue Prekpalaj**, shtetas italian, lindur ne Prizren, i datëlindjes 20.12.1983, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti italiane CA58856CH

themelojme një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

**“N & A Services Fornitures” SHPK**

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

**Neni 2: Selia**

Selia e shoqërisë do të jetë:

**Lagjja 13, Rruga “ Palmave”, Iliria, Plazh, Godina nr. 7, Durrës.**

Shoqeria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashte vendit.

**Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj si vijon:

Aktivitet ne fushen e punimeve te ndertimit dhe te mirembajtjes. Punime elektike dhe hidraulike. Instalimi I impianteve hidraulike, higjenike, kuzhina, lavanteri, hidrosanitare, si dhe mirembajtja e tyre. Instalimi I impianteve elektrike dhe mirembajtja e tyre. Punime bojatisje –hidroizolim

– akustike –kundra zjarrit, punime suvatimi, patinimi, gipsi e kartonxhesi.  
Punime karpentierie druri. Punime karpenterie metalike.

Tregtim, Import-eksport artikuj te ndryshem industriale, lende te para, artikuj hidro-sanitare, hidraulike, elektrike, mobilje te ndryshme, pajisje elektrike e elektronike, etj.

Ndermjetesim ne tregun e punes. Agjensi Punesimi.

Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash per vete per te trete e me qira.

Sherbime logjistike dhe translogu ambjentesh te ndryshme, zyra, shtepi, hotele, etj.

Arredim ambjentesh te ndryshme, zyra, hotele, shtepi, qendra tregtare, etj.

Aktivitet ne fushen e pasurive te paluajtshme, dhenie me qira, etj. Agjenci imobiliare.

Pjesmarrje ne evente dhe panaire te ndryshme, arredim e montim stendash per evente e Panaire, etj.

Shoqeria ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj..

#### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

#### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është **100.000**(njeqindmije) lekë, i ndarë në 2 kuota. aKontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

- 1. Armand Zeneli** është zotërues i 1 kuote, me 50 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 50.000 leke.
- 2. Nue Prekpalaj** është zotërues i 1 kuote, me 50 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 50.000 leke.

### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- (-) Asambleja e Përgjithshme.
- (-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Armand Zeneli** për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti. Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve të Shoqërisë

**Nue Prekpalaj**



**Armand Zeneli**

